



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Berat më ____ .05.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Blerje karburant për nevojat e agjencisë** i ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1 “Blerje Gazoil për nevojat e agjencisë ”

Loti 2 : “Blerje benzinë “

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP)_
09134100-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 12.422.138 (dymbëdhjetë milion e katërqind e njëzet e dy mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) Lek pa TVSH

Loti 1: me fond limit prej: **11 919 373** (njëmbëdhjetë milion e nëntëqindë e nëntëmbëdhjetë mijë e treqindë e shtatëdhjetë e tre) pa TVSH

Loti 2: me fond limit **502 765** (pesëqindë e dy mijë e shtatëqindë e gjashtëdhjetë e pesë) pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Për Lotin 1 dhe Lotin 2 kriteret e kualifikimit si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të lotit/shumës së loteve që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse Operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën 1 (një) vit të periudhës të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43, pika 2, paragrafi b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, ku përcaktohet se në procedurat ndërmjet kufirit të lartë dhe ulët monetar vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Bazohet në nenin 43, pika 2, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar :

* në nenin 43 pika 1 të VKM 285/2021 “Mbi Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;

* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve tre viteve të fundit financiare, **2022-2023-2024** që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njepasnjeshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit **Nr.** 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Ligjin **Nr.** 25/2018 datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të Ligjit **Nr.** 9920, datë 19.5.2008” Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Neni 57), Ligjit **Nr.** 10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, si dhe VKM-së **Nr.** 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të lotit/ shumës së loteve që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- **Vërtetime të lëshuara nga një ent publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizura, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, dhe të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë për Tregtim me pakicë të karburanteve të lëshuar nga organet e pushtetit vendor (Bashkia Berat) .

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5 germa a, 5. “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 Stacion Tregtimi karburanti në territorin e Bashkisë Berat të vërtetuar me Niptin përkatës dhe të pasqyruara në Ekstraktin e shoqërisë.

Këto stacione të jenë të pajisura me Vertetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), dhe Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Shqipëri, për distributoret e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave

Argumentimi : Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK-së është bërë duke patur parasysh vendodhjen e objektit të bashkisë, numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe inteneraret ditore të grupeve të tererentit . që kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale, dhe se OE veprojnë brenda kornizës ligjore në fuqi lidhur me dokumentacionin përkatës për stacionet e shitjes me pakicë të karburantit.

Në zbatim të VKM Nr.561 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme” sherbimi i furnizimit me karburant duhet te kryhet vetem nepermjet kartes elektronike,e cila mundeson identifikimin e mjetit dhe perdoruesin e saj.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë ISO 9001:2015, ose ekuivalente (për të vertetuar që operatori i plotëson kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë) lëshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentim:*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.*

2.3.5. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në çdo stacion furnizimi të tij, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të AK sipas kërkesave të AK. Lista e automjeteve, Tipi dhe Targa e secilit automjet do të jenë pjesë e kontratës së fituesit, me AK.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Argumentimi :Referuar kërkesës së mësipërme duke qenë se AK është në shërbim operativ 24/7 lind nevoja e shërbimit 24 orë të furnizimit.

2.3.6.Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant, detyrimisht me pistoletë publike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 dhe 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kjo kërkesë është vendosur bazuar në objektin e prokurimit, kriter i nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës dhe që subjekti ushtron veprimtarinë sipas legjislacionit në fuqi për tregëtimin e karburabteve.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Fletë Analiza të lëshuar nga ISHTI për produktin **Gazoil 10 PPM S SH EN:590 :2022** dhe **Benzinë S SH EN 228** lëshuara jo më parë se 1 vit nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure si dhe bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 40 pika 6, gjurmë ”c” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standartet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Ky kriter është vendosur me qëllim konfirmimin e standarteve të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”.

Ky raport fletë-analizë për produktin , krijon siguri që karburanti të jetë me cilësi sipas normave ndërkombetare,dhe sipas normave të përcaktuara nga ISHTI

2.3.8. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë furnizimin me karburant me kartë elektronike, e cila duhet të jenë pa skadencë dhe të jetë e përdorshme dhe gjatë vitit 2025 në përputhje me Vendimin e Keshillit të Ministrave **Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”**.

Argumentim:

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje dhe në zbatim me VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet janë hartuar nga specialisti i fushës anëtar i njësisë së prokurimit, konform legjislacionit të prokurimit në fuqi dhe garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë.

NJESIA E PROKURIMIT

Roland Deda	Personi përgjegjës
Fradiol Droboniku	specialist i fushës
Brikena Halitaj	Specialiste finance

MIRATOHET

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

JOANA MELENGU